



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

KKDM/Nr. ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/03 / 2022

**VENDIM**

Nr.09, date 30 /03/2022

**PËR**

**RISHIKIMIN E LEGJISLACIONIT NE FUSHEN E PROJEKTIMIT, NDERTIMIT,  
SHFRYTEZIMIT, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGAVE**

Në mbështetje te Ligjt Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" i rishikuar, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.03.2022 mori në shqyrtim cështjen e problematikat e hasura si dhe domosdoshmérinë në lidhje me rishikimin dhe përmirësimit të legjislacionit në fushën e Projektimit, Ndërtimit, Shfrytëzimi, Monitorimit dhe Sigurisë së digave. Aktualisht në këtë fushë operohet përmes Ligjt Nr.8681, datë 02.11.2000, "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", i rishikuar si dhe Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave të aprovuar me VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 si dhe disa vendime dhe Udhëzime në lidhje me funksionimin e KKDM.

Gjatë diskutimeve u konkludua se gjatë eksperiencës së deritanishme të zbatimit të legjislacionit të mësipërm, vihet re se janë të nevojshme rishikimi, aktualizimi dhe përmirësimi i këtij legjislacioni.

Konkretnisht, gjatë diskutimeve u theksua se është e domosdoshme,

- Të qartësohen dhe forcohen aspektet ligjore në lidhje me sigurinë e digave ekzistuese dhe zonat poshtë tyre. Në legjislacionin ekzistues nuk flitet në lidhje me klasifikimin e digave sipas rrezikut të tyre në zonat urbane poshtë tyre;
- Të merren në konsideratë ndryshimet që janë bë në 20 vitet e fundit në lidhje me pronësine e tyre dhe shfrytëzuesit e digave. U theksua se aktualisht 95 % e digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim shfrytëzohen nga bashkitë dhe pjesa më e madhe e digave të mëdha që përdoren për prodhim hidroenergji shfrytëzohen nga shoqëri private. Kjo situatë kërkon forcimin e kontrollit të shtetit në drejtim të monitorimit dhe sigurisë së këtyre digave dhe zonat poshtë tyre.
- Përfshirja e kërkesave në lidhje me standartet dhe kërkesat teknike në fushën e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha;
- Të merren në konsideratë ndryshimet ligjore që janë bë në këto vite në lidhje me emergjencat civile, menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- Të merren në konsideratë ndryshimet klimatike dhe kërkesat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- Të shqyrtohet dhe të rishikohen problematikat e hasura gjatë këtyre viteve nga mosfunkcionimi i Inspektoriatit Teknik të Digve (ITD), si strukture pranë Sekretariatit Kombëtar i Digave të Mëdha. Gjithashtu, është e domosdoshme të rishikohen kërkesat për bashkëpunimin ndërmjet të gjithë institucioneve dhe aktoreve që veprojnë në këtë fushë dhe që janë përgjegjës për shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave;
- Të forcohen masat penalizuese ndaj shkelësve të kërkesave teknike për monitorimin dhe sigurinë e digave si dhe për mosplotësimin dhe mosbatimin e kërkesave në lidhje me sigurinë e zonave poshtë digave. Kjo kërkesë është e lidhur me rëndësinë e vecantë të digave, përsa i përket vlerave ekonomike ashtu edhe rrezikun që paraqesin në rastet e prurjeve të mëdha apo prishjeve të mundshme të tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

- Të merren në konsideratë kërkesat e reja të ICOLD në lidhje me sigurinë e digave dhe standartet teknike të tyre. Duhet theksuar se një sërë vendesh në Europë si Spanja, Gjermania, Franca, Italia, Suedia kanë rishikuar dhe përmirësuar legjislacionin në fushën e shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha;

Pas diskutimeve të tē gjithë antarëve në lidhje me problematikat dhe cështjet e mësipërme, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Ti propozoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Këshillit të Ministrave rishikimin dhe përmirësimin legjislacionit aktual në fushën e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit, monitorimit dhe Sigurisë së digave duke marrë në konsideratë cështjet e mësipërme.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të këruara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

